REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 871/20
Datë/Datum. 30.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**220-70001-0731-20-5789-1-2-1**
Nr i brendshëm	**033-2020**

Sa i përket tenderit për: Furnizim me Sterilizator Plazma me Material përcjellës hargjues.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SOLUTION D sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ekrem Rexha nr. 28
(Adresa)

Prishtine — ***10000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

038 233 233 — ***038603524***
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Driton Sanaja
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

sales@solutiond.net
(Adresa elektronike)

30.10.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

SH. P. K. Solution ADMINISTRATA

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë me dt. 25.09.2020 Afati i fundit për dorëzimin e ofertave me dt. 16.10.2020 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 22.10.2020 Kërkesa për rishqyrtim me dt:27.10.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 10 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 67 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me dt. **22.10.2020** përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, me letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm, ndërsa ka rekomanduar për kontratë OE **N.SH.T. "MADE-KOS".**

Fillimisht ju sqarojmë se ne me dt. 22.10.2020 kemi bërë kërkesë për qasje në dokumentacione.

Ndërsa me datë 23.10.2020 kemi pranuar një email nga AK-ja ku e ka cekur se *"Duke u bazuar ne nenin 11 informatat sekrete afariste ku te gjitha dokumentet e tenderit të cilat janë dorëzuar nga OE konform neni 68,69 dhe 70 trajtohet si sekret afarist.*
Dokumenti i tenderit i dërguar nga OE Ekonomik konform neni 68,69,70. Janë dokumente private dhe publikimi i tyre pa te drejtën e OE e papërgjegjshme dhe mund te ndikon ne dëmtim te biznesit dhe demit material", pra nga emaili i përmendur më lartë OE i rekomanduar për kontratë e ka deklaruar të gjithë dokumentacionin e tij si sekret afarist, andaj ne dyshojmë se ky OE është i papërgjegjshëm dhe nuk i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Pra AK-ja e ka cekur se i gjithë dokumentacioni i OE të rekomanduar për kontratë është sekret afarist dhe na ka lejuar ta shikojmë vetëm raportin e vlerësimit.

Andaj pasi që nuk na është lejuar qasja në dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë sipas nenit 10.3 të LPP-së ne dyshojmë se ky OE është i papërgjegjshëm si në vijim:

Ne dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat tek neni 8.1&8.2 tek Kapaciteti ekonomik dhe financiar, ku kërkesë ka qenë *"Vërtetimin nga banka se ka qarkullim bankar se paku 120,000.00€ për tri vitet e fundit,* ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"OE duhet te dëshmon me vërtetim nga banka komerciale qe ka qarkullim 120,000.00euro për tri vitet e fundit"*. Pra ne dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur dhe është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu në dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 9.1&9.2 ku kërkesë ka qenë *"1. Listën e kontratave te realizuar për tri vitet fundit 2. Se paku tri kontrata dhe tri referenca për lami te ngjashme 3. Autorizim nga Prodhuesi për shitjet dhe servisim 4. Çertifikata Iso 9001 për Operatorin Ekonomik 5. Çertifikata Iso 13485 për prodhuesin dhe CE Çertifikata për prodhuesin 6. Lista e pjesëve rezervë 7. Licenca nga AKPPM 8.Katalogu i nënvizuar"* ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"1. OE duhet te dëshmon me Listën e kontratave te realizuar për tri vitet fundit 2. OE duhet te dëshmon se paku tri kontrata dhe tri referenca për lami te ngjashme 3. OE duhet te dëshmon me Autorizim nga Prodhuesi për shitjet dhe servisim 4. OE duhet te dëshmon me Certifikata Iso 9001 për Operatorin Ekonomik dhe te ketë validitet 5. OE duhet te dëshmon me Çertifikata Iso 13485 për prodhuesin dhe CE Çertifikata për prodhuesin 6. OE duhet te dëshmon me Lista e pjesëve rezervë 7. OE duhet te dëshmon me Licencë nga AKPPM me validitet 8.OE duhet te dëshmon me Katalogu i nënvizuar"*.

Pra duke u bazuar në faktin se nuk na është lejuar qasja në dokumente pasi që sipas AK-së OE i rekomanduar për kontratë e ka deklaruar sekret afarist të gjithë dokumentacionin e tij, ne dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën 1 dhe 2 të lartcekur në lidhje me kontratat pasi që kontratat e realizuara është absurde të deklarohen si sekret afarist pasi që, kontratat dhe nënshkrimi i tyre publikohet edhe në faqet e autoriteteve kontraktuese, andaj ky fakt na bën të dyshojmë edhe më shumë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe se nuk i ka ofruar dëshmitë në lidhje me kërkesat e lartcekura, pra OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar listën e kontratave dhe tri kontrata të prezantuara bashkë me referenca.

Gjithashtu ne dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka përmbushur kërkesën 3 ku është kërkuar autorizimi nga prodhuesi për shitjet dhe servisimin ashtu siç e cekëm më lartë, pasi që edhe ky dokument si dokumentet tjera është deklaruar sekret afarist. Pra ne dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka prezantuar në ofertë fare autorizimin nga prodhuesi, andaj edhe është i papërgjegjshëm.

Po ashtu në dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin nuk e përmbush kërkesën 4 dhe 5 në lidhje me ISO Certifikatën *9001* për operatorin ekonomik dhe ISO Certifikatën *13485* dhe CE certifikatën për prodhuesin. Ne dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka prezantuar fare certifikatat e lartcekura, ose ka prezantuar certifikata tjera të cilat nuk janë konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Dyshimet tona po shtohen dhe njëkohësisht po vërtetohen edhe më shumë pasi që ne në lidhje me ISO Certifikatën *13485* dhe CE certifikatën për prodhuesin, kemi kontrolluar dhe gjatë kontrollës në Kinë ne e kemi vërtetuar direkt nga prodhuesi se OE i rekomanduar për kontratë nuk i posedon këto certifikata specifikisht per sterilizatorin plasma. Andaj sa i përket vërtetimit nga prodhuesi fakti se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm po vërtetohet edhe më shumë dhe dyshimet janë edhe më të mëdha në momentin që OE i ka deklaruar sekret afarist edhe certifikatat e lartcekura.

OE i rekomanduar për kontratë dyshojmë se është i papërgjegjshëm edhe për faktin se ky OE nuk i ka plotësuar edhe kërkesat me nr. *6. Lista e pjesëve rezervë dhe 7. Licenca nga AKPPM,* pasi që nëse do ti plotësonte këto kërkesa nuk do ti deklaronte si sekret afarist. Gjithashtu ne dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën nr.*8* ku është kërkuar Katalogu i nënvizuar, pasi që edhe katalogu e prezantuar e ka deklaruar sekret afarist ose nuk e ka ofruar fare.

Po ashtu dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson edhe specifikimet teknike të FDT-së, andaj kërkojmë nga ju që të detyroni AK të vërtetoj edhe një herë se a i përmbush apo jo të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë OE i rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu edhe OE Arben S. Ismajli B.I i renditur si i dyti me çmim në këtë aktivitet të prokurimit, dyshojmë se është i papërgjegjshëm për faktin se nuk na është lejuar qasja në dokumentacionin e tij.

Në dyshojmë se OE i lartcekur është i është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat tek neni 8.1&8.2 tek Kapaciteti ekonomik dhe financiar, ku kërkesë ka qenë "*Vërtetimin nga banka se ka qarkullim bankar se paku 120,000.00€ për tri vitet e fundit,* ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "*OE duhet te dëshmon me vërtetim nga banka komerciale qe ka qarkullim 120,000.00euro për tri vitet e fundit*". Pra ne dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur dhe është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu në dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 9.1&9.2 ku kërkesë ka qenë "*1. Listën e kontratave te realizuar për tri vitet fundit 2. Se paku tri kontrata dhe tri referenca për lami te ngjashme 3. Autorizim nga Prodhuesi për shitjet dhe servisim 4. Çertifikata Iso 9001 për Operatorin Ekonomik 5. Çertifikata Iso 13485 për prodhuesin dhe CE Çertifikata për prodhuesin 6. Lista e pjesëve rezervë 7. Licenca nga AKPPM 8.Katalogu i nënvizuar*" ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "*1. OE duhet te dëshmon me Listën e kontratave te realizuar për tri vitet fundit 2. OE duhet te dëshmon se paku tri kontrata dhe tri referenca për lami te ngjashme 3. OE duhet te dëshmon me Autorizim nga Prodhuesi për shitjet dhe servisim 4. OE duhet te dëshmon me Certifikata Iso 9001 për Operatorin Ekonomik dhe te ketë validitet 5. OE duhet te dëshmon me Çertifikata Iso 13485 për prodhuesin*

dhe CE Çertifikata për prodhuesin 6. OE duhet te dëshmon me Lista e pjesëve rezervë 7. OE duhet te dëshmon me Licencë nga AKPPM me validitet 8.OE duhet te dëshmon me Katalogu i nënvizuar".

Pra duke u bazuar në faktin se nuk na është lejuar qasja në dokumente pasi që, ne dyshojmë se OE i lartcekur nuk e plotëson kërkesën 1 dhe 2 të lartpërmendur në lidhje me kontratat pasi që kontratat e realizuara është absurde të deklarohen si sekret afarist pasi që, kontratat dhe nënshkrimi i tyre publikohet edhe në faqet e autoriteteve kontraktuese, andaj ky fakt na bën të dyshojmë edhe më shumë se OE Arben S. Ismajli B.I është i papërgjegjshëm dhe se nuk i ka ofruar dëshmitë në lidhje me kërkesat e lartcekura, pra OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar listën e kontratave dhe tri kontrata të prezantuara bashkë me referenca.

Gjithashtu ne dyshojmë se OE i lartcekur është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka përmbushur kërkesën 3 ku është kërkuar autorizimi nga prodhuesi për shitjet dhe servisimin ashtu siç e cekëm më lartë. Pra ne dyshojmë se ky OE nuk e ka prezantuar në ofertë fare autorizimin nga prodhuesi, andaj edhe është i papërgjegjshëm.

Po ashtu në dyshojmë se OE Arben S. Ismajli B.I është i papërgjegjshëm edhe për faktin nuk e përmbush kërkesën 4 dhe 5 në lidhje me ISO Certifikatën *9001* për operatorin ekonomik dhe ISO Certifikatën *13485* dhe CE certifikatën për prodhuesin. Ne dyshojmë se OE i lartpërmendur nuk i ka prezantuar fare certifikatat e lartcekura.

OE i Arben B. Ismajli B.I dyshojmë se është i papërgjegjshëm edhe për faktin se ky OE nuk i ka plotësuar edhe kërkesat me nr. *6. Lista e pjesëve rezervë dhe 7. Licenca nga AKPPM.* Gjithashtu ne dyshojmë se OE i lartpërmendur nuk e plotëson edhe kërkesën nr.*8* ku është kërkuar Katalogu i nënvizuar, dyshojmë se ky OE nuk e ka ofruar fare katalogun ose nuk e ka nënvizuar.

Po ashtu dyshojmë se OE Arben S. Ismajli B.I nuk i plotëson edhe specifikimet teknike të FDT-së, andaj kërkojmë që të detyroni AK të vërtetoj edhe një herë se a i përmbush apo jo të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë ky OE.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura pasi që nuk na është lejuar qasja në dokumentet e OE Arben S. Ismajli B.I me këtë rast nuk është respektuar neni 10.3 i LPP-së dhe ne nuk kemi munduar të analizojmë dokumentacionin e OE në fjalë, ne dyshojmë se ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm në lidhje me të gjitha kërkesat e lartcekura dhe duhet të shpallet i papërgjegjshëm.

Ne me dt.28.10.2020 kemi pranuar një email nga autoriteti kontraktues, në të cilin email AK-ja e ka cekur se na është lejua qasja në disa prej dokumenteve ku e ka cekur se zyrtari jonë ka bërë disa foto dhe disa dokumente i ka marrë në kopje fizike dhe gjithashtu e ka cekur se në asnjë mënyrë nuk ka thënë se e gjithë oferta OE është sekret afarist, mirëpo ky arsyetim i AK-së nuk qëndron për faktin se AK-ja po e vë veten e saj në lajthitje sepse në emailin e dt.23.10.2020 e ka cekur shumë qartë se *"Duke u bazuar ne nenin 11 informatat sekrete afariste ku te gjitha dokumentet e tenderit të cilat janë dorëzuar nga OE konform neni 68,69 dhe 70 trajtohet si sekret afarist.*
Dokumenti i tenderit i dërguar nga OE Ekonomik konform neni 68,69,70. Janë dokumente private dhe publikimi i tyre pa te drejtën e OE e papërgjegjshme dhe mund te ndikon ne dëmtim te biznesit dhe demit material", pra nga emaili i përmendur më lartë OE i rekomanduar për kontratë e ka deklaruar të gjithë dokumentacionin e tij si sekret afarist dhe arsyetimi i AK-së se nuk qëndron ky pretendim është shumë kundërthënës dhe njëkohësisht i pa bazuar.

Ndërsa në lidhje me arsyetimin e AK-së ku e ka cekur se OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ky arsyetim i AK-së nuk qëndron

për faktin se nëse ky OE do ti kishte plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë atëherë AK-ja me fakte dhe dëshmi do të na vërtetonte se pretendimet tona nuk qëndrojnë, mirëpo që nuk ka ofruar asnjë fakt apo dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.
Në emailin të cili e kemi pranuar ne të dt.28.10.202, nga ana e AK-së, është cekur shumë qartë nga se ju njoftojmë me kohë për vendimin e AK-së lidhur me kërkesën tonë për rishqyrtim, AK-ja është munduar vetëm të na e humb afatin kohor për parashtrimin e ankesës në OSHP, pasi që nuk ka dërguar asnjë vendim për refuzimin apo aprovimin e kërkesës tonë për rishqyrtim.

Përkundrazi sot me dt.30.10.2020 AK-ja ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës edhe pse ne nuk kemi marrë ndonjë vendim për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim. AK-ja me këtë veprim nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të nenit 108/A të LPP-së ku është cekur shumë qartë se *"Autoriteti kontraktues mund, me anë të një vendimi:*

1.1.të refuzojë kërkesën e propozuar për shqyrtim si të pabaza;

1.2.të miratojë një kërkesë për rishikim si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht ose tërësisht vendimin e miratuar;, pra përderisa AK-ja nuk na ka dërguar një vendim për refuzim apo aprovim të kërkesës për rishqyrtim, shihet qartë se nuk është respektuar dispozita e lartcekur e LPP-së.

Gjithashtu AK-ja me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës nuk i ka respektuar afatet ligjore për parashtrimin e ankesës në OSHP përkatësisht nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të nenit 109 të LPP-së ku është e cekur shumë qartë se: *Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji"*, pra duke u bazuar në dispozitat e lartcekura shihet qartë se ju keni publikuar njoftimin për dhënie të kontratës pa kaluar afati ligjor për parashtrimin e ankesës në OSHP prej 10 ditësh dhe gjithashtu pa publikuar një vendim për refuzim apo aprovim të kërkesës tonë për rishqyrtim edhe përkundër faktit se ju në emailin lartcekur e keni theksuar se do të ju informojmë në lidhje me kërkesën tuaj për rishqyrtim. Ky veprim i juaji vërteton edhe më shumë faktin se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që jeni munduar që sa më shpejt të bëni publikimin e vendimit për dhënie të kontratë vetëm e vetëm që ne mos të bëjmë ankesë në OSHP.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet qe u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse e keni rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i AK-së është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Autoriteti kontraktues është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"SOLUTION D" sh.p.k**
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*